



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*  
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*  
*Ministry of Regional Development*

**Raporti i zbatimit të**  
**Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar**  
**për vitin 2023**

Dhjetor, 2024

## Tabela e përmbajtjes

HYRJE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
Koordinimi dhe monitorimi i projekteve.....	5
RAPORTI PËRMBLEDHËS .....	7
Raporti përmbledhës për Rajonin - Qendër.....	10
Raporti përmbledhës për Rajonin – Lindje.....	11
Raporti përmbledhës për Rajonin – Jug.....	13
Raporti përmbledhës për Rajonin – Veriu.....	14
Raporti përmbledhës për Rajonin – Perëndim.....	15
Përfundimi .....	17

## Lista e tabelave

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara.....	6
Tabela 2: Shpërndarja e mjeteve financiare për PZHRB 2023, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	7
Tabela 3: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Start Up, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	8
Tabela 4: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore .....	9
Tabela 5: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore .....	9
Tabela 6: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Qendër, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore .....	10
Tabela 7: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Lindje, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	12
Tabela 8: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Jug, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	13
Tabela 9: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Veri, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore.....	14
Tabela 10: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2022 në rajonin: Perëndim, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore .....	16

## Lista e figurave

Figura 1: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare të PZHRB-së.....	8
Figura 2: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Qendër.....	11
Figura 3: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Lindje.....	12
Figura 4: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Jug.....	13
Figura 5: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Veriu.....	15
Figura 6: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Perëndim.....	15

## Shkurtesat

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonaj
DPKZHR	Departamenti për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal
PZHRB	Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar

## HYRJE

“Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar” është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të qeverisë dhe institucioneve ndërkombëtare për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë të rajoneve brenda vendit. Programi synon të reduktojë dallimet ekonomike dhe sociale midis rajoneve dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët që jetojnë në zonat më të prapambetura.

Ministria e Zhvillimit Rajonal në vitin 2023, ka vazhduar me implementimin e Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, i cili program ndër vite ka dhënë ndikim të dukshëm në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në rritjen e mundësive ekonomike në rajonet që tradicionalisht kanë pasur më shumë sfida për zhvillim. Ky program ka ndihmuar në uljen e pabarazive ekonomike dhe ka kontribuar në një zhvillim më të balancuar të Kosovës.

Buxheti i planifikuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, për realizimin e këtij programi, në vitin 2023 ishte rreth 1.6 mil. euro dhe kjo mbështetje financiare u tregua dobiprurëse, duke u mundësuar përfituesve të bizneseve ekzistuese që të forcohen dhe më tej në veprimtarit e tyre biznese ndërsa përfituesve të Start Up-eve iu dha mundësinë që të nisnin realizimin e ëndrrës për të bërë biznes.

Synimet specifike të kësaj mbështetje financiare, ishin:

- ✓ Përkrahja e bizneseve të reja dhe zhvillimi i bizneseve me potencial rritjeje;
- ✓ Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve;
- ✓ Përkrahja e bizneseve që kontribuojnë në rritjen e eksportit;
- ✓ Zvogëlimi i papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë.

Duke pasur parasysh përpjekjet dhe rezultatet deri tani, mund të thuhet se synimet kryesore të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023 janë arritur në disa aspekte, veçanërisht në përmirësimin e infrastrukturës dhe mbështetje për biznese të vogla dhe të mesme.

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i zbatimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023 është i bazuar në të dhëna të mbledhura nga monitorimi i përfituesve në terren dhe të analizuara përmes metodës së intervistës dhe metodës së analizës.

Nga thirrja për "Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2023" janë përzgjedhur gjithsej 131 projekt-propozime nga të pesë rajonet zhvillimore por vetëm 127 prej tyre u zbatuan, pasi që 4 (katër) projekt-propozime dështuan<sup>1</sup>.

Mbështetja financiare u fokusua në tre kategori, si:

- **Start - Up** - e cila iu dedikohej ideve të biznesit (të cilat nuk janë ende të regjistruara si biznese);
- **Loti 1: Biznese ekzistuese** - e cila iu dedikohej ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (me një qarkullim prej 2,000.00€ deri në 29,999.99€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuara nga ATK) dhe
- **Loti 2: Biznese ekzistuese** - e cila iu dedikohej mikro dhe të vogla (me një qarkullim prej 30,000.00€ deri në 300,000.00€ nga viti i fundit kalendarik, të dëshmuara nga ATK).

Sipas të dhënave të shpërndarjes së mjeteve financiare, nga rreth 1.6 mil. euro të planifikuar - 18% e këtij buxheti apo rreth 266 mijë euro u ndanë për kategorinë: Start Up, ku përfituan gjithsej 57 përfitues; 31% apo 477 mijë euro e buxhetit të planifikuar u ndanë për kategorinë: Lot 1 ku përfituan gjithsej 36 përfitues, dhe 51% apo 780 mijë euro e buxhetit të planifikuar u nda për kategorinë Lot 2 meqë raste përfituan gjithsej 34 përfitues.

Pas realizimit të këtyre projekteve numri i përgjithshëm i të punësuarve arriti në 275 persona.

### Koordinimi dhe monitorimi i projekteve

MZHR me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të programit ka caktuar monitorues, në pesë rajone zhvillimore, si:

1. Gresa Gashi, Monitoruese për rajonin zhvillimor: Qendër;
2. Amil Velija, Monitorues për rajonin zhvillimor: Jug dhe Lindje,
3. Shqipe Kadrijaj, Monitoruese për rajonin zhvillimor: Veri dhe Perëndim.

---

<sup>1</sup> Projekt-propozimet të cilat për një arsye apo një tjetër dështuan apo u diskualifikuan ishin projekte të rajonit: Lindje (Start Up - 3 projekt-propozime dhe Lot 2 - 1 projekt-propozim).

Zyrtarët monitorues kanë realizuar monitorimet në vendin e ngjarjes, tek bizneset përfituese, ku nga afër kanë parë pajisjet dhe funksionalitetin e biznesit dhe pas verifikimit të gjendjes në terren dhe verifikimit të dokumenteve të listës së punëtorëve (sipas deklaramit në aplikacion) përfituesit i është proceduar edhe pjesa e dytë e pagesës nga mjetet e përfituara.

Në tabelën më poshtë po i prezantojmë të dhënat e monitorimeve sipas rajonit, lot-eve dhe numrit të monitorimeve sipas secilit zyrtar monitorues veç e veç.

Tabela 1: Zyrtarët monitorues në rajonet zhvillimore dhe numri i monitorimeve të realizuara

Zyrtari monitorues	Rajoni	Start Up	Lot 1	Lot 2	Gjithësej
Gresa Gashi	Qendër	12	7	7	26
	Lindje	9	7	6	22
Amill Velija	Jug	12	8	8	28
	Veri	12	7	6	25
Shqipe Kadrijaj	Perëndim	12	7	7	26
	<b>Totali:</b>	<b>57</b>	<b>36</b>	<b>34</b>	<b>127</b>

Burimi: DPKZHR - MZHR

Procesi i monitorimi të projekteve të financuara nga thirrja për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023, sikurse edhe në të kaluarën, ka hasur në disa sfida kryesore, duke përfshirë: kapacitetet e kufizuara të monitorimit, vonesat në implementim të projektit dhe vështirësitë e matjes së ndikimit të drejtpërdrejtë.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Për shkak të këtyre sfidave që janë hasur gjatë procesit të monitorimit është vonuar grumbullimi i të dhënave si dhe hartimi i raportit të zbatimit të PZHRB për vitin 2023.

## RAPORTI PËRMBLEDHËS

Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) për vitin 2023 është një iniciativë e rëndësishme që synon të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të barabartë të rajoneve të Kosovës, duke ulur pabarazitë ekonomike dhe sociale ndërmjet rajoneve më të zhvilluara dhe atyre më të pazhvilluara.

Ministria e Zhvillimit Rajonal ndau rreth 1.6 mil. euro për të mbështetur sektorin privat dhe për të iu mundësuar ndërmarrësve të rinj që projektet e tyre të zhvillohen më tej në forcimin e sektorëve që ata ndër veprojnë - prodhim apo shërbim dhe në krijimin e vendeve të reja të punës.

Në tabelën 2, është pasqyruar shpërndarja e mjeteve financiare për Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar, për vitin 2023, sipas rajoneve zhvillimore, prej ku përfituan gjithsej 127 projekt-propozime nga sektori i shërbimeve dhe prodhimit.

Tabela 2: Shpërndarja e mjeteve financiare për PZHRB 2023, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

	<i>Rajoni zhvillimor</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<b>PZHRB 2024</b>	Qendër	26	326,406.00	139,807.00	466,213.00	52
	Lindje	22	291,126.00	124,334.24	415,460.24	54
	Jug	28	305,394.90	138,246.80	443,641.70	65
	Veri	25	296,971.90	116,005.74	412,977.64	51
	Perëndim	26	303,104.00	120,831.08	423,935.08	53
	<b>Totali</b>	<b>127</b>	<b>1,523,002.80</b>	<b>639,224.86</b>	<b>2,162,227.66</b>	<b>275</b>


Burimi: DPKZHR - MZHR

Nga të dhënat në tabelë, kuptojmë se mesatarja e projekt-propozimeve fituese sipas rajoneve zhvillimore ishte 25 projekte dhe mesatarisht u shpërndan rreth 305 mijë euro për secilin rajon zhvillimor.

MZHR, mesatarisht, mbështeti bizneset përfituese nga PZHRB me rreth 70% të vlerës së përgjithshme të projekt-propozimit dhe 30% e projekteve u financua nga vet bizneset përfituese. Gjatë zbatimit të projekteve u punësuan gjithsej 275 punëtor të rinj në pesë rajonet zhvillimore, e që i bie se në secilin rajon zhvillimor, mesatarisht, u punësuan nga 55 punëtor.

Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare është paraqitur në figurën 1, ku 21% pjesëmarrje kishte rajoni zhvillimor: Qendër; me nga 20% kishin rajonet zhvillimor: Jug, Veri dhe Perëndim dhe 19% kishte rajoni zhvillimor: Lindje.

Figura 1: Pjesëmarrja e rajoneve zhvillimore në mbështetjen financiare të PZHRB-së



Burimi: DPKZHR - MZHR

Numri më i madh i përfituesve ishte nga kategoria: Start Up, ku përfituan gjithsej 57 projekt-propozime nga pesë rajonet zhvillimore dhe mesatarja e vlerës së përgjithshme të shumës së mbështetjes nëpër rajonet zhvillimore ishte mbi 53 mijë euro.

Tabela 3: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Start Up, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

	Rajoni zhvillimor	Nr. i përfituesve	Kontributi i MZHR	Kontributi i përfituesit	Shuma totale e projektit	Nr. të punësuarve
PZHRB 2024, Start Up	Qendër	12	57,204.00	8,654.00	65,858.00	22
	Lindje	9	43,180.00	6,222.44	49,402.44	15
	Jug	12	53,634.90	9,107.80	62,742.70	22
	Veri	12	54,541.90	8,443.74	62,985.64	22
	Perëndim	12	57,092.00	10,254.18	67,346.18	21
	<b>Totali</b>	<b>57</b>	<b>265,652.80</b>	<b>42,682.16</b>	<b>308,334.96</b>	<b>102</b>

Burimi: DPKZHR - MZHR

MZHR mbështeti me 86% financimin e vlerës së përgjithshme të projekt-propozimeve të kategorisë Lot 1: Start Up dhe rreth 14% të vlerës së mbetur e mbuluan vet përfituesit e bizneseve. Në këtë kategori të bizneseve u punësuan gjithsej 102 punëtor të rinj dhe rajoni



zhvillimor me më së paku të punësuar ishte rajoni zhvillimor: Lindje me vetëm 15 punëtor të rinj të punësuar.

Tabela 4, na jep të dhënat e shpërndarjes së mjeteve financiare për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese sipas rajoneve zhvillimore që përfshin pjesëmarrjen prej 31% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare, nga e cila përfituan gjithsej 36 biznese nga të pesë rajonet zhvillimore.

Tabela 4: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

	<i>Rajoni zhvillimor</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<b>PZHRB 2024, Lot 1</b>	Qendër	7	99,452.00	48,138.00	147,590.00	13
	Lindje	7	97,946.00	46,374.00	144,320.00	17
	Jug	8	89,810.00	43,559.00	133,369.00	12
	Veri	7	100,880.00	45,602.00	146,482.00	11
	Perëndim	7	89,011.00	41,597.90	130,608.90	13
	<b>Totali</b>	<b>36</b>	<b>477,099.00</b>	<b>225,270.90</b>	<b>702,369.90</b>	<b>66</b>

Burimi: DPKZHR - MZHR

Kategorinë: Lot 1, MZHR e mbështeti, mesatarisht, me 86% të vlerës së përgjithshme të projekt-propozimeve dhe rreth 32% të vlerës së mbetur e mbuluan vet përfituesit e bizneseve. Në këtë kategori u punësuan 66 punëtor të rinj me rastin e zbatimit të projekteve dhe rajoni zhvillimor me më së paku të punësuar ishte rajoni zhvillimor: Veri, ku u punësuan vetëm 11 punëtorë të rinj.

Tabela 5: Shpërndarja e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

	<i>Rajoni zhvillimor</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<b>PZHRB 2024, Lot 2</b>	Qendër	7	169,750.00	83,015.00	252,765.00	17
	Lindje	6	150,000.00	71,737.80	221,737.80	22
	Jug	8	161,950.00	85,580.00	247,530.00	31
	Veri	6	141,550.00	61,960.00	203,510.00	18
	Perëndim	7	157,001.00	68,979.00	225,980.00	19
	<b>Totali</b>	<b>34</b>	<b>780,251.00</b>	<b>371,271.80</b>	<b>1,151,522.80</b>	<b>107</b>

Burimi: DPKZHR - MZHR

Të dhënat lidhur me shpërndarjen e mjeteve financiare për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese sipas rajoneve zhvillimore janë prezantuar në Tabela 5.

Në kategorinë Lot 2 përfituan gjithsej 34 biznese dhe përfshin pjesëmarrjen prej 51% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare dhe meqë rast MZHR mbështeti me 68% financimin e vlerës së përgjithshme të projekt-propozimeve të kësaj kategorie dhe 32% të vlerës së mbetur e mbuluan vet përfituesit e bizneseve.

Për dallim nga kategoritë e tjera të mbështetura, në kategorinë: Lot 2 numri i të punësuarve ishte 107 të punësuar të rinj dhe rajoni zhvillimor me më së shumti të punësuar ishte rajoni zhvillimor: Jug.

### Raporti përmbledhës për Rajonin - Qendër

Rajoni zhvillimor: Qendër, kishte pjesëmarrje me 21% në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare. Numri i përgjithshëm i projekt-propozimeve që fituan dhe u implementuan ishte 57, ku vlera e përgjithshme e atyre që implementuan projekt-propozimet ishte rreth 308 mijë euro, prej ku 86% e kësaj vlere u mbështet nga MZHR dhe rreth 14% nga vet bizneset përfituese.

Tabela 6: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Qendër, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	12	57,204.00	8,654.00	<b>65,858.00</b>	22
<i>Lot 1</i>	7	99,452.00	48,138.00	<b>147,590.00</b>	13
<i>Lot 2</i>	7	169,750.00	83,015.00	<b>252,765.00</b>	17
<b><i>Totali:</i></b>	<b>26</b>	<b>326,406.00</b>	<b>139,807.00</b>	<b>466,213.00</b>	<b>52</b>


Burimi: DPKZHR – MZHR & (Gresa Gashi, Monitorues në rajonin zhvillimor: Qendër, 2023)

Nga të dhënat del se, 50% e bizneseve përfituese u mbështetën me vlerën maksimale të mbështetjes, sipas publikimit në Thirrjet publike për aplikim, ku 8 projekt-propozime i takuan kategorisë: Start Up, 3 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 2 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

Në kuadër të implementimit të projekt-propozimeve nga të tre kategoritë, u punësuan gjithsej 52 punëtor të rinj – 22 punëtor në kategorinë: Start Up, 13 punëtor në kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 17 punëtor në kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

Në figurën 2, është prezantuar pjesëmarrja e Lot-eve në buxhetin e shpenzuar për rajonin zhvillimor: Qendër, ku rreth 52% e këtyre mjeteve u nda për projektet përfituese të kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese dhe 30% e këtyre mjeteve u nda për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese ndërsa 18% prej tyre u nda për kategorinë: Start Up.

Figura 2: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Qendër



Burimi: DPKZHR – MZHR

Nga shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për rajonin zhvillimor: Qendër, pjesëmarrja prej 52% u shpenzua për 7 projektet përfituese në kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese në shumë prej rreth 170 mijë euro.


### Raporti përmbljedhës për Rajonin – Lindje

Rajoni zhvillimor: Lindje kishte 19% pjesëmarrje në vlerën e përgjithshme të mbështetjes financiare dhe ishte rajoni zhvillimor me më së paku pjesëmarrje në vlerën e përgjithshme. Pjesëmarrja e këtij rajoni zhvillimor u ul për shkak se pas shpalljes së rezultateve të projekt – propozimeve fituese, gjatë fazë së implementimit të projektit, 4 (katër) prej përfituesve u tërhoqën nga shuma e përfituar, ku prej tyre:

- 3 projekt-propozime ishin nga kategoria: Start Up, me vlerën e përgjithshme të tyre 15,000.00 euro dhe
- 1 projekt-propozim ishte nga kategoria: Lot 2 - Biznes ekzistues, me vlerën prej 24,300.00 euro.

Nga shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për rajonin zhvillimor: Lindje, pjesëmarrja prej 51% u shpenzua për 6 projektet përfituese në kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese në shumë prej 150 mijë euro.

Figura 3: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Lindje



Burimi: DPKZHR – MZHR

Në rajonin zhvillimor: Lindje përfituan gjithsej 22 biznese aplikuese, ku: 9 prej të cilave i takonin kategorisë: Start Up, 7 i takonin kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 6 të tjera i takonin kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese. Në tabelën 7, janë paraqitur në total të dhënat e bizneseve përfituese sipas Lot-eve, të këtij rajoni.

Tabela 7: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Lindje, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	9	43,180.00	6,222.44	<b>49,402.44</b>	15
<i>Lot 1</i>	7	97,946.00	46,374.00	<b>144,320.00</b>	17
<i>Lot 2</i>	6	150,000.00	71,737.80	<b>221,737.80</b>	22
<b><i>Totali:</i></b>	<b>22</b>	<b>291,126.00</b>	<b>124,334.24</b>	<b>415,460.24</b>	<b>54</b>

Burimi: DPKZHR – MZHR & (Amill Velija, Monitorues në rajonin zhvillimor: Lindje dhe Jug, 2023)

MZHR mbështeti me mbi 291 mijë euro nga 415 mijë euro sa ishte vlera totale e projekteve përfituese apo me 70% të vlerës së përgjithshme të projekt-propozimeve dhe 30% e pjesës së vlerës së mbetur të projekteve fituese u financua nga vet bizneset përfituese.

Gjatë fazës së zbatimit të projekt-propozimeve u punësuan gjithsej 54 punëtorë të rinj dhe nga të dhënat del se, 68% e bizneseve përfituese u mbështetën me vlerën maksimale të mbështetjes, sipas publikimit në Thirrjet publike për aplikim, ku 5 projekt-propozime i takuan kategorisë: Start Up, 4 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 6 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

## Raporti përmbledhës për Rajonin – Jug

Rajoni zhvillimor: Jug merr pjesë 20% në vlerën e përgjithshme të mjeteve financiare të ndarë për PZHRB 2023. Në tabelën 8, janë prezantuar të dhënat e bizneseve përfituesve, ku: 12 prej tyre i takojnë kategorisë: Start Up, 8 i takojnë kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 8 të tjera i takojnë kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.


Tabela 8: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Jug, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	12	53,634.90	9,107.80	<b>62,742.70</b>	22
<i>Lot 1</i>	8	89,810.00	43,559.00	<b>133,369.00</b>	12
<i>Lot 2</i>	8	161,950.00	85,580.00	<b>247,530.00</b>	31
<b><i>Totali:</i></b>	<b>28</b>	<b>305,394.90</b>	<b>138,246.80</b>	<b>443,641.70</b>	<b>65</b>

Burimi: DPKZHR – MZHR & (Amill Velija, Monitorues në rajonin zhvillimor: Lindje dhe Jug, 2023)

Shuma e mjeteve që u nda nga MZHR tek përfituesit e projekt-propozimeve përfituese ishte mbi 305 mijë euro apo 69% e vlerës së përgjithshme të projekteve përfituese dhe pjesa tjetër e projekteve, prej rreth 31%, u financua nga vet bizneset përfituese.

Figura 4: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Jug



Burimi: DPKZHR – MZHR

Gjatë zbatimit të projekt-propozimeve u punësuan 65 punëtorë të rinj. Në figurën 5, u prezantua pjesëmarrja e Lot-eve në buxhetin e realizuar për rajonin zhvillimor: Jug, ku 18% e këtyre mjeteve u nda për projektet përfituese të kategorisë: Start Up, 29% për kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 53% për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

## Raporti përmbledhës për Rajonin – Veriu

Rajoni zhvillimor: Veri gjithashtu ka pjesëmarrje prej 20% në vlerën e përgjithshme të mjeteve financiare të ndara për PZHRB 2023, e cila shumë u shpërnda tek 25 përfitues, ku: 12 prej tyre i takuan kategorisë: Start Up, 7 i takuan kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 6 përfitues i takuan kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

Vlera e përgjithshme e projekteve përfituese ishte rreth 413 mijë euro dhe nga MZHR u mbështet 72% të vlerës së përgjithshme të projekteve dhe gjatë zbatimit të projektit u punësuan 51 punëtor të rinj.

Nga të dhënat del se, 32% e bizneseve përfituese u mbështetën me vlerën maksimale të mbështetjes, sipas publikimit në Thirrjet publike për aplikim, ku 3 projekt-propozime i takuan kategorisë: Start Up, 3 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 2 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.


Tabela 9: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2023 në rajonin: Veri, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	12	54,541.90	8,443.74	<b>62,985.64</b>	22
<i>Lot 1</i>	7	100,880.00	45,602.00	<b>146,482.00</b>	11
<i>Lot 2</i>	6	141,550.00	61,960.00	<b>203,510.00</b>	18
<b><i>Totali:</i></b>	<b>25</b>	<b>296,971.90</b>	<b>116,005.74</b>	<b>412,977.64</b>	<b>51</b>

Burimi: DPKZHR - MZHR & (Shqipe Kadrijaj, Monitoruese në rajonin zhvillimor: Veri dhe Perëndim, 2023)

Në figurën 5, është prezantuar pjesëmarrja e Lot-eve në buxhetin e shpenzuar për rajonin zhvillimor: Veri, ku 18% e këtyre mjeteve u nda për projektet përfituese të kategorisë: Start Up, 34% u nda për projektet përfituese të kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 48% për kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

Figura 5: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Veriu




Burimi: DPKZHR – MZHR

Nga shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për rajonin zhvillimor: Veri, pjesëmarrja prej 48% u shpenzua për 6 projektet përfituese në kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese në shumë prej mbi 141 mijë euro.

### Raporti përmbledhës për Rajonin – Perëndim

Rajoni zhvillimor: Perëndim, është rajoni i cili kishte 20% pjesëmarrje në vlerën e përgjithshme të mjeteve financiare të ndara për PZHRB 2023.

Figura 6: Pjesëmarrja e lot-eve në buxhetin e ndarë për rajonin zhvillimor: Perëndim



Burimi: DPKZHR – MZHR

Nga shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për rajonin zhvillimor: Perëndim, pjesëmarrja prej 52% u shpenzua për 7 projekte përfituese në kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese në shumë prej 157 mijë euro. Shuma e mjeteve e cila u nda për 26 përfituesit e projekt-propozimeve ishte mbi 303 mijë euro apo shprehur në përqindje 71% e vlerës së përgjithshme të projekteve që u mbështetën nga MZHR.

Tabela 10: Shpërndarja e mjeteve financiare të PZHRB-së 2022 në rajonin: Perëndim, nr. i përfituesve dhe nr. i të punësuarve sipas rajoneve zhvillimore

<i>Lot</i>	<i>Nr. i përfituesve</i>	<i>Kontributi i MZHR</i>	<i>Kontributi i përfituesit</i>	<i>Shuma totale e projektit</i>	<i>Nr. të punësuarve</i>
<i>Start Up</i>	12	57,092.00	10,254.18	<b>67,346.18</b>	21
<i>Lot 1</i>	7	89,011.00	41,597.90	<b>130,608.90</b>	13
<i>Lot 2</i>	7	157,001.00	68,979.00	<b>225,980.00</b>	19
<i>Totali:</i>	<b>26</b>	<b>303,104.00</b>	<b>120,831.08</b>	<b>423,935.08</b>	<b>53</b>

Burimi: DPKZHR – MZHR & (Shqipe Kadrijaj, Monitoruese në rajonin zhvillimor: Veri dhe Perëndim, 2023)

Nga të dhënat del se, rreth 31% e bizneseve përfituese u mbështetën me vlerën maksimale të mbështetjes, sipas publikimit në Thirrjet publike për aplikim, ku 5 projekt-propozime i takuan kategorisë: Start Up, 1 projekt-propozime i takoi kategorisë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 2 projekt-propozime i takuan kategorisë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.

Në kuadër të implementimit të projekt-propozimeve nga të tre kategorive u punësuan gjithsej 53 punëtor të rinj –21 punëtor në kategorinë: Start Up, 13 punëtor në kategorinë: Lot 1 - Biznese ekzistuese dhe 19 punëtor nga kategorinë: Lot 2 - Biznese ekzistuese.



## Përfundimi

Ky program ka kontribuar në zhvillimin e rajoneve më të pazhvilluara të Kosovës dhe përpjekjet për të vazhduar dhe përmirësuar këto investime janë jetike për një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të vendit.

Shuma e mjeteve, e cila u dedikua në shërbim të këtij qëllimi, ishte mjaft solide dhe prej saj përfituan numër i vogël i bizneseve mikro dhe të vogla që funksionojnë në Kosovë, vlen të theksohet se ndikimi që dha kjo ndihmë bëri që bizneset të forcojnë kapacitetet e tyre të rriten dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre edhe më tej, si për nga aspekti i të bërit biznes - po ashtu edhe për nga ana e numrit të të punësuarve.

Bazuar në synimet që kishe në fillim mbështetja financiare e PZHRB-së 2023, u arrit që:

- ✓ të përkrahet zhvillimi i bizneseve me potencial rritjeje dhe të ndikohet pozitivisht në rritjen dhe forcimin e tyre;
- ✓ të përkrahen biznese që kontribuojnë në zëvendësimin e importeve edhe pse në këtë pikë ndikimi i mbështetjes financiare ishte tejet i zbehët por që gjithsesi u fuqizuan disa biznese prodhuese, si dhe
- ✓ të zvogëlohet papunësia përmes krijimit të vendeve të reja të punës, me theks të veçantë për të rinjtë.

Në përgjithësi, Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar për vitin 2023 ka arritur disa rezultate pozitive, por ka ende sfida që duhet të adresohen.

Për të përmirësuar implementimin dhe monitorimin e programeve të ngjashme në të ardhmen, rekomandohet:

- Përforcimi i kapaciteteve institucionale: Forcimi i kapaciteteve të institucioneve të monitorimit për të siguruar një implementim më efikas dhe mbikëqyrje të detajuar të projekteve.
- Përmirësimi i koordinimit dhe komunikimit: Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve qeveritare, partnerëve ndërkombëtarë dhe sektorit privat për të siguruar realizimin e suksesshëm të projekteve.

- Përmirësimi i të dhënave dhe monitorimit: Kritja e përdorimit të sistemeve të menaxhimit të informacionit dhe të dhënave për monitorimin e projekteve dhe vlerësimin e ndikimit.

Zhvillimi rajonal përfshin një përpjekje të gjerë për të përmirësuar mirëqenien dhe standardet e jetesës në rajone të ndryshme, duke përfshirë qendrat urbane deri në zonat rurale.

Në fund mund të vijmë në përfundim se sektori privat i veprimtarisë prodhuese dhe shërbyese tek bizneset e reja dhe ato të vogla në Kosovë padyshim që ka nevojë për mbështetje dhe përkrahje si nga ana financiare apo ashtu edhe në krijimin e lehtësirave tatimore.